



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 2867/Prot

Shkodër, më 04. 3.2022

Lënda: Kthim përgjigje

KLODIANA NDERSHTIQAJ

(Email: klodiana.ndershtiqaj@gmail.com)

E nderuar znj. Ndershtiqaj,

Në vijim të emailit Tuaj datë 22.02.2022, Ju informojmë si mëposhtë vijon:

1. *Sa kohë ka zyra e projektit "Bashkitë për në Evropë" që është hapur në bashkinë Shkodër?*

Zbatimi i projektit startoi nga Delegacioni i Bashkimit Evropian me datë 11 tetor 2017, në Bashkinë Lushnje. Pas lancimit të projektit, me kërkesën e stafit të projektit filloi puna njëherazi për 61 bashkitë në vend me nxjerrjen e urdhërit për ngritjen e grupit të punës dhe ngritjen e zyrës së çeshtjeve të BE-së pranë secilës bashki. Me datë 21 tetor të po këtij viti është inaguruar Këndi i BE në Bashkinë Shkodër. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Shkodër ngriti Urdhërin për caktimin e koordinatorit dhe zv. koordinatorit, detyrat e të cilëve ishin përcaktuar nga vetë projekti për 61 bashkitë në vend. Këto dy nëpunës civil (koordinatori dhe zv.koordinatori) kanë mbuluar edhe më përpara procesin e 'integritit evropian' në Bashkinë Shkodër. Përzgjedhja e tyre është bërë në respektim të kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Për më shumë klikoni në linkun:

<https://www.facebook.com/370972339675306/posts/1291745327597998/?sfnsn=mo>

2. *Kush është personi/at që drejton zyrën e projektit "Bashkitë për në Evropë" të financuar nga BE-ja? Kush e ka emëruar këtë person në krye të kësaj detyre?*

Bashkia Shkodër ka patur të parashikuar në strukturën e saj organizative sektorin e planifikimit strategjik si sektorin përgjegjës për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve të Bashkimit Evropian.

Në vazhdim të projektit "Bashkitë për Evropën", Këshilli i Ministrave me vendim nr. 450, datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integritit Evropian,

ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit të Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore përcaktoi përgjegjësitë e strukturës së integritimit evropian për bashkërendimin e strukturave administrative dhe përfaqësimin e bashkisë në marrëdhënie me strukturat e qeverisjes qendrore përgjegjëse për integrimin evropian, me qëllim realizimin e funksioneve të veta apo të deleguara në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe të zbatimit të asistencës së Bashkimit Evropian për këtë proces.

Prandaj detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në projektin “Bashkitë për në Evropë” dhe VKM 450, datë 26.07.2018 janë vazhdim i punës së sektorit të Planifikimit pranë Bashkisë Shkodër. Këto detyra dhe përgjegjësi janë të materializuara edhe në formularin e përshkrimit të punës për secilin nga nëpunësit civil, pjesë e këtij sektori.

Aktualisht përgjegjë i këtij sektori është znj. Joana Mjekaj.

Arsimi: Bachelor Fakulteti Ekonomik, Dega Turizëm, Master Shkencor për Turizmin e qendrueshëm. Trajnime të ndryshme per: Shkrimin e Projekteve; Trajnim për Marketing Territorial: Etiketim i Produkteve dhe Rajoneve; Marketingu i Turizmit Territorial dhe Teknikat e Menaxhimit; etj.

3. Me çfarë merret konkretisht kjo zyrë?

Funksioni i kësaj zyre lidhen me:

- ✓ Koordinim i brendshëm për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, ngritjen e kapaciteteve për përthitjen e fondeve nga programet europiane.
- ✓ Shkëmbimin e eksperiencave më të mira.
- ✓ Një qendër informimi e bashkisë ku publiku të mund të marrë informacion për çështjet, programet e BE-së, etj.
- ✓ Ure komunikimi ndërmjet komunitetit, bashkive, qeverisë dhe BE-së.
- ✓ Organizim eventesh për çështjet e BE-së/ditët e BE,së Ditët kombëtare të vendeve anëtare, etj.
- ✓ Zbatim projektesh të financuara nga programe të ndryshme të BE dhe donatorë të tjerë.

Gjithashtu duam të nënvizojmë faktin se Bashkia Shkodër është e para bashki në vend e cila në zbatim të VKM nr. 450, datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integritimit Evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit të Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore, ne kemi integruar në mënyrë të përmbledhur detyrat e përcaktuara në VKM në buxhetin e vitit 2019 dhe programin buxhetor afatmesëm 2019-2021, sëbashku me fishat e tjera që kanë ekzistuese që kanë si tematikë integrimin evropian.

4. Cili është roli i saj në lidhje me progresin që bën bashkia dhe për integrimin evropian?

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë tashmë rolin e tyre të mirë përcaktuar në procesin e integritimit evropian. Ky rol i vetëqeverisjes vendore në zbatimin e politikave, në zbatimin e Acqui Communautaire dhe në axhendën e integritimit evropian është shumë i rëndësishëm. Komisioni Evropian e theksoi përsëri këtë rol në Komunikimin e vitit 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së si vijon: “Roli i autoriteteve rajonale dhe vendore duhet të merret parasysh në procesin e harmonizimit me BE-në dhe në zbatimin eventual të rregullave të BE-së. Duhet gjetur një ekuilibër i përshtatshëm mes qeverisë qendrore, rajonale dhe asaj vendore që mbështet më së miri zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët”.

Në këtë kuadër është hartuar *matrica e vlerësimit të performancës*, e cila evidenton rëndësinë e rolit të pushtetit vendor në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kjo matricë përmban të dhënat për realizimin e detyrimeve që lindin në kuadër të procesit të anëtarësimit nga secila bashki. Mbi bazën e këtyre të dhënave përgatitet edhe Raporti i Vlerësimit. Ky raport është mbështetur në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian 2017-2020 dhe Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë. Raporti është hartuar me kontributin e Projektit “Bashkitë për në Evropë” dhe Njësive të Integritimit Evropian në 61 bashkitë e vendit, në rolin e koordinatorit të procesin të brendshëm të mbledhjes së të dhënave. Raporti paraqet progresin e bërë nga bashkitë shqiptare për vitet 2017-2021 në lidhje me përmbushjen e përgjegjësive siç përcaktohet nga kuadri ekzistues strategjik dhe ligjor, në lidhje me përafrimin me kriteret e pranimit dhe me standardet e BE- së.

Një informacion më të detajuar si për Bashkinë Shkodër ashtu edhe për 60 bashkitë e tjera të vendit tonë mund ta gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, në linkun:

https://bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_ne_proceset_e_integritimit_evropian_1294_1.php

Si dhe në faqen zyrtare të projektit “Bashkitë për në Evropë”, në linkun:

<https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>

5. *Si organizohet dhe koordinohen punët në një ditë normale brenda në zyrë? Si organizohet puna kur ka një projekt ose veprimtari të tjera?*

Puna është e organizuar në mbështetje të rregullores së brendshme të Bashkisë Shkodër, planit vjetor të punës, planit mujor të punës dhe respektimit të kalendarit të aktiviteteve të miratuar nga Bashkia Shkodër. Informacionin e gjeni të publikuar në linkun: https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Programi_i_Transparences_i_Bashkise_Shkoder_553_1.php

Në rastin e menaxhimit të projekteve me financim të huaj, praktika ka treguar se mund të realizohet në dy forma:

- ✓ Menaxhim me staf të jashtëm, nënkontraktim i stafit të jashtëm për zbatimin e projektit.
- ✓ Menaxhim me staf të brendshëm, angazhimi i nëpunësve të shërbimit civil.

6. Si bini në kontakt me të ardhurat për financimin e këtyre projekteve? A merrni buxhetin e plotë 100% nga financimi që ju bën BE apo një pjesë e mban bashkia?

Bashkia Shkodër ndër vite ka patur partneritete të suksesshme, kjo e përkthyer në finalizime të projekteve në disa bashkëpunime. Ftesat për bashkëpunim nga partnerët e përhershëm të saj kanë qënë të shpeshta në disa programe. Programet janë të ndryshme dhe mundësitë për të përfituar nga ndihma e huaj vijnë gjithnjë duke u shtuar.

Për vendosjen e partneritetit kemi përdorur plaformat e “partner search” të programeve që e disponojnë një të tillë por mbajmë kontakte edhe me institucionet menaxhuese të programeve dhe donatorë të ndryshëm. Deri tani nuk kemi pasur probleme me buxhetin apo zbatim e projekteve.

Në buxhetin vjetor të Bashkisë Shkodër është parashikuar fish projekti P04130.O1.A5. Pjesmarrje në programet dhe projektet të financuara nga Bashkimi European dhe Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare. Kjo fishe i dedikohet projekteve dhe aktiviteteve ndërkombëtare.

7. Cfarë rezultatesh dhe punësh keni arritur deri tani që ti kryeni?

Një informacion më të detajuar si për Bashkinë Shkodër e gjeni në linkun:

https://bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_ne_proceset_e_integrimit_evropian_1294_1.php

Si dhe në faqen zyrtare të projektit “Bashkitë për në Evropë”, në linkun:

<https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>

KRYETAR

Voltana Ademi